



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 22 prill 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Mimoza Ahmetaj, Flora Brovina, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Teuta Hadri.

Munguan: Slobodan Petroviq, Nurishahe Hulaj dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta - nëpunëse administrative
Nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës: Jusuf Ulaj - drejtor
Nga Qendra Emergjente: Basri Lenjani - drejtor
Nga FSSHK: Asllan Bajrami dhe Zyle M - Gojnovci
Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri
Nga-NDI: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Takimi i Komisionit me drejtorin e QKUK-së dhe me përfaqësuesit e Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa plotësime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua me plotësimin që e bënë në diskutimet e tyre deputetët Gjylnaze Sylja dhe Armend Zemaj.

3. Takimi i Komisionit me drejtorin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe me përfaqësuesit e Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës

Kryetari - Pasi i përshëndeti të pranishmit tha se Komisioni e ka marrë një kërkesë, një raport nga drejtori i Qendrës Emergjente dhe një kërkesë nga Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës. Komisioni ka vendosur që t'i dëgjojë përfaqësuesit e këtyre sektorëve në shëndetësi, në mënyrë që të shihet çka mund të bëjmë në këtë situatë. Fillimisht fjalën e mori drejtori i QKUK-së, Jusuf Ulaj.

Jusuf Ulaj – drejtor i QKUK-së - E falënderoi Komisionin për interesimin për gjendjen në QKUK. Puna në QKUK është shumë stresuese, shumë e rëndë, nën një presion të madh për arsye të ndryshme. Problemi më i madh është mungesa e barnave dhe i materialit sanitar. Në QKUK çdo ditë ballafaqohemi me mungesë të heparinës pa të cilën nuk funksionon dializa, po ashtu mungon fentanila që është anestetik, ndërsa brenda ditës kemi më së paku njëqind operacione. Sasia e barnave që vjen mjafton për një ditë ose për një ditë e gjysmë. Këtu menjëherë lind dilema, nëse kjo sasi duhet të lihet për Qendrën Emergjente ose të përdoret për ata që në mjekësi quhen raste të ftohta – pacientë të shtrirë në spital dhe që presin operacionin.

Është obligim i Divizionit farmaceutik të Ministrisë së Shëndetësisë që ta furnizojë me barna QKUK-në. Ne vazhdimisht bëjmë kërkesa për furnizim me barna, por procedurat shtyhen me arsyetimin se kjo është pasojë e vitit 2006-të. Problem paraqesin mediat që e pengojnë stafin në kryerjen e punëve. Ai tha se e ka lëshuar një urdhëresë me të cilën mediat mund të drejtohen vetëm në Zyrën për Informim në QKUK. QKUK-ja ka problem edhe me borxhet e kaluara. Ai ia dorëzoi Komisionit raportin e një komisioni të Ministrisë së Shëndetësisë në të cilin shihet se borxhi nga viti i kaluar është diku 800 mijë euro mallra dhe shërbime, 260 mijë euro janë shpenzime komunale dhe mbi 400 mijë investime kapitale. E gjithë kjo është diku 1 milion e gjysmë euro, duke ditur që kjo nuk është e tëra. Kam bërë tri shkresa lidhur me atë se si do të veprojmë me borxhet e vitit të kaluar që ia kam drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe në asnjërin prej tyre nuk kam marrë përgjigje. Disa projekte të Ministrisë së Shëndetësisë nga bordi i përkohshëm janë bartur në QKUK, duke shkaktuar kështu një përzierje të kompetencave. Investime kapitale për këtë vit në QKUK nuk ka. Nuk ka mjete të ndara për barna dhe për material sanitar. Nga kjo mund të shihni se në çfarë gjendje është QKUK-ja. Ne po ashtu kemi pasur disa auditime, kemi 24 orë inspektoratin shëndetësor që na sjellin raporte ditore. Kemi vështirësi sa i përket zbatimit të Statutit - sidomos lidhur me çështjen e decentralizimit, parkimit si dhe me mungesën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve. Në Ministrinë e Shëndetësisë ka shpërputhje ndërmjet asaj që thuhet dhe asaj që realizohet.

Basri Lenjani nga Qendra Emergjente - Tha se kërkesat e stafit menaxhues të QKUK-së dhe të Qendrës Emergjente, për furnizim të qëndrueshëm me barna, me material shpenzues dhe me aparatura mjekësore kanë mbetur vetëm premtim. Problemet me të cilat ballafaqohet Qendra Emergjente i kemi paraqitur ne raportin që e kemi dorëzuar në këtë komision. Mjekët e Qendrës Emergjente janë të ngarkuar- stresuar, megjithatë ata nuk kërkojnë ngritje pagash, por kushte elementare për punë, që të mos kenë presione të vazhdueshme nga familjarët. Edhe pse puna është e rëndë këta punëtorë nuk gëzojnë asnjë beneficion. Nuk mund të paguhet si motra që punon në

gjinekologji, që punon në sallën e operimit, si mjeku që punon në emergjencë 24 orë pa ndërprerë. Po ashtu nuk dallohet mjeku i ri nga profesori. Ata kërkojnë katër beneficione: super pagesa prej 100 - 150%, stazhi i beneficuar të jetë prej 12 - 16 muaj dhe pushimi vjetor të jetë 35 - 40 ditë për shkak të natyrës së rëndë të punës në Qendrën Emergjente. Punëtorët janë të revoltuar edhe në Federatën Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës që nuk ka aktivitete sindikale. Nga të dhënat statistikore për vitin 2007 del sa është e ngarkuar Qendra Emergjente nga rastet joemergjente që paraqesin problem të madh. Problem tjetër paraqesin rastet emergjente dhe joemergjente në bazë të patologjisë emergjente dhe joemergjente nga trevat e ndryshme të Kosovës që dërgohen pa ndonjë kriter. Ne dëshirojmë të kemi përkrahje shtetërore. Është momenti i fundit që të merremi seriozisht me këtë problematikë shumë të madhe. Është koha që shërbimet mjekësore të kenë prioritet për investime kapitale në Konferencën e donatorëve.

Asllan Bajrami nga Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës - Pasi i përshëndeti të pranishmit tha se kanë pasur takim me ministrin e Shëndetësisë lidhur me padinë që FSSHK-ja e ka bërë në gjykatë. Është fjala për 3.5 milionë euro që rrjedhin nga një marrëveshje e arritur ndërmjet FSSHK-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë e të Financave, në prani të kryeministrit të mandatit të kaluar. Kjo marrëveshje për stimulimin e punëtorëve shëndetësorë nuk është realizuar kurrë. Po ashtu FSSHK-ja e ka iniciuar një procedurë disiplinore ndaj të gjithë personave përgjegjës financiarë në institucionet shëndetësore që sipas Rregullores 52/2004 obligohen që punëtorëve t'ua paraqesin pasqyrën e të dhënave të kontributeve në cilësinë e tatimit në të ardhura, por këtë nuk e kanë bërë. Gjithashtu kujdestaria llogaritet si punë e dytë. Është për t'u çuditur se ajo tatóhet sikur punë e dytë, ndërsa është e detyrueshme. Jemi të interesuar të bëhemi partnerë seriozë që e ndihmojnë qeverisjen.

Kryetari – I falënderoi përfaqësuesit për informatat dhënë këtij komisioni. Jam i kënaqur që gjendja ka filluar të qetësohet, sepse Qeveria ka vendosur që QKUK-ja t'i menaxhojë barnat. I ftoi anëtarët e Komisionit për pyetje eventuale.

Teuta Hadri - Tha se shëndetësia në Kosovë sot është më keq se dikur shoqata "Nëna Terezë". Ajo tha se deri diku e kupton se problem është mungesa e heparinës dhe e fentanilës, por nuk mund ta kuptojë mungesën e ergometrinës në Klinikën e Gjinekologjisë, pa të cilën për disa minuta një pacient i shëndoshë mund të vdesë nga gjakderdhja. Ajo tha se në QKUK duhet të ketë prioritete. Kujdes duhet t'u kushtohet gjërave elementare. Një përgjegjësi të madhe e ka edhe Sindikata, nëse nuk bëhet sistematizimi i pagave që specialisti të mos paguhet si mjeku i praktikës së përgjithshme. FSSHK -ja e ka nënshkruar një marrëveshje me kryeministrin Çeku, me të cilën ka garantuar që kujdestaritë e mjekëve të paguhen rregullisht. Deri më sot janë katër milionë euro që nuk i shfrytëzon askush.

Qamile Morina – I përshëndeti të pranishmit dhe tha se gjendja në QKUK është tejet e rëndë. Furnizimi me barna dhe menaxhimi i buxhetit deri në vitin 2006 është bërë nga Ministria e Shëndetësisë, domethënë ka qenë një menaxhim qendror. Në vitin 2006 Qeveria Çeku e decentralizoi dhe i lejoi QKUK-së ta bëjë vetë furnizimin me barna. Raporti që më është dorëzuar sot është mjaft brengosës për faktin se kur mjekët e udhëheqin QKUK-në dhe e dinë buxhetin që e ka QKUK-ja, bëjnë aq shumë shpenzime të panevojshme pa i caktuar prioritetet. Nga momenti kur ka shkuar bordi - më intereson ta di kush është ai në Ministrinë e Shëndetësisë që përsëri deshi ta centralizonte fondin. Gjithashtu me intereson të di për tatimin e pagave në shëndetësi. Sipas informatave që kam punëtorët e shëndetësisë tatóhen në paga 20%. Nga organizimi juaj, mjekimi intensiv është i interesit nacional. Mjekimi intensiv ka pasur nevojë për renovim dhe zgjerim për arsye se kapaciteti i mjekimit intensiv ka qenë i ulët. Në vitin 2006 janë ndarë nga buxheti 350 mijë euro për zgjerimin e kapacitetit të mjekimit intensiv. Ajo tha se gjatë gjithë kësaj kohe askush në QKUK nuk flet për cilësi, por vetëm për furnizime. Përkrah z. Lenjani që Qendra Emergjente ta ketë

fondin të ndarë nga institucioni i QKUK-së. Sa janë të hyrat nga laurat, nga qiratë dhe nga participimi.

Mimoza Ahmetaj – E parashtroi pyetjen se a ka diçka që duhet të ndryshohet në Statutin e QKUK-së për ofrimin më të mirë të shërbimeve shëndetësore të dorës së tretë. Çka është ajo që duhet të ndërrohet në Statut dhe në ligj?

Gjylnaze Syla – E parashtroi pyetjen për z. Ulaj: Nëse do t'i kishit bërë tri prioritete, si do t'i kishit definuar ato? Pra, a mendoni që buxheti duhet të centralizohet apo të decentralizohet dhe a mendoni se ndoshta më mirë është që menaxhimi i QKUK-së të bëhet nga profesionistë të tjerë e jo nga mjekët, nga juristët etj.

Për Qendrën Emergjente problem është hapësira. Nga ajo që kuptova është përkrahur projekti për zgjerim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria e Japonisë. Në cilën fazë ka mbetur projekti?

Më intereson ta di a ka iniciuar Sindikata diçka në lidhje me ndryshimin e statusit të mjekëve në mënyrë që ata të mos konsiderohen shërbyes civilë?

Armend Zemaj - Tha se vitin e kaluar ka qenë një bord i emëruar prej Qeverisë për ta rregulluar çështjen në QKUK. Ju jeni drejtor në QKUK që nga tetori. Mua më intereson çështja e keqpërdorimeve financiare në QKUK. Kam lexuar në një artikull gazete se janë shpenzuar më se 1 milion euro pa mbulesë.

Në tetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave kam gjetur se ka pasur mjete të lira në shumën prej 698 mijë euro, ndërsa ju thoni se keni ekspertë të financave dhe të auditimit. Unë mendoj se po të kishit pas ekspertë të financave dhe të auditimit, nuk do ta kishit këtë listë të borxheve pa fatura - pa mbulesa.

Në bazë të të dhënave që kam marrë nga thesari dhe nga raporti i QKUK-së, nuk po përputhen të dhënat tuaja me ato të Ministrisë. Si do të dilni prej kësaj situatë zoti drejtor? Konsideroj se kjo nuk ka të bëjë me presionet politike, por më tepër ka të bëjë me njerëzit adekuatë që e bëjnë këtë punë. Konsideroj se QKUK-ja duhet ta ketë një planifikim për furnizim me barna. A keni bashkëpunimin të duhur me njëri-tjetrin?

E kam marrë një letër, sipas së cilës në QKUK ka mungesë të penjve, ndërsa inspektorët sanitarë në depon qendrore kanë gjetur 70 lloje të penjve.

Rita Hajzeraj - Tha se ne po e shohim që nuk ka koordinim ndërmjet QKUK-së, Qendrës Emergjente dhe Ministrisë së Shëndetësisë. A keni strategji si të funksionojë ose si të dilet nga kjo situatë? E dimë që në depon e Mazgitit ka me mijëra barna që nuk përdoren. Kush po e pengon përdorimin e tyre, kur shumë njerëz vdesin për barna esenciale?

Flora Brovina - Tha se jam e brengosur për zbehjen e rolit dhe të pozitës së punëtorit shëndetësor në shëndetësi dhe konsideroj se kjo nuk është vetëm çështje e Sindikatës, por është çështje e tërë shoqërisë.

Ajo që më brengos është se Statuti i QKUK-së është i pazbatueshëm. Çka mendoni, cilat janë vështirësitë për zbatimin e këtij statuti dhe cili është roli ynë për tejkalimin e kësaj gjendjeje?

Ne e kemi ligjin për Emergjencën: Sa për qind zbatohet ky ligj? Gjithashtu ju thatë se ka shumë pacientë që dalin nga klinika pa u evidencuar. Po të ishte mbajtur kjo evidencë siç duhet, sa do të ndihmonte edhe në të dhënat e tjera statistikore? Sa mjete do të ishin grumbulluar? Përkatësish sa njerëz janë ata që nuk evidencohen?

Kryetari - Tha se gjendja në shëndetësi është shumë e rëndë. Në depot qendrore ka shumë barna që janë donacione dhe u ka skaduar afati që nga vitet 2002 dhe 2003. Pastaj i kemi edhe disa barna që fare nuk i nevojiten Kosovës. Në Mazgit kemi barna për krejt Ballkanin, të cilave u ka skaduar afati

dhe është shumë vështirë të asgjësohen. Ato barna janë blerë atëherë kur ka qenë kompetencë e stafit ndërkombëtar. Kemi edhe stoqe të mëdha të penjve, që nuk nevojiten për asgjë.

Jusuf Ulaj - Tha se është fatkeqësi që shëndetësia nuk është ndër prioritetet e Qeverisë. Sa i përket ergometrinës, kjo është përgjegjësi e Divizionit Farmaceutik në Ministrinë e Shëndetësisë. Ajo që ndodhi në Mazgit nuk është përgjegjësi e QKUK-së, ndërsa sa i përket planifikimit, në më 01 të çdo muaji bëjmë kërkesën për furnizim të QKUK-së me barna dhe material sanitar. Kush deshi të centralizohet fondi? Kjo pyetje duhet t'i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë. Sa i përket Statutit të QKUK-së, sigurisht duhet të punohet sipas Statutit dhe para se të bëhet çdo hap në planin tonë duhet të ndryshohet Statuti. Sa i përket decentralizimit, së pari duhet të decentralizohet QKUK-ja nga Ministria e Shëndetësisë, pastaj të bëhen decentralizime të tjera që janë të parapara me këtë statut. Sa u përket tri prioriteteve, prioriteti i parë janë barnat, pastaj buxheti dhe menaxhimi.

Asllan Bajrami - Tha se ekziston një vendim i veçantë i Qeverisë që kujdestaria të kalojë në vijën buxhetore të pagave dhe të mëditjeve e jo si deri më tash nga participimi. Ai participim ka mbetur i lirë për stimulimin e punëtorëve dhe mu për këtë është bërë padi në gjykatë, ndërsa për rimbursim nuk kemi paqartësi, por kemi ngathtësi të punëtorëve financiarë.

4. Të ndryshme

Komisioni vendosi që në muajt e ardhshëm të organizojë vizita në disa qendra të Kosovës, në qendrat për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara, pastaj të vizitohet shtëpia e komunitetit për persona me aftësi të kufizuara, si dhe të vizitohen qendrat kryesore të mjekësisë familjare.

Kryetari i Komisionit, bashkë me drejtorin e QKUK-së dhe me kryetarin e Federatës Sindikale të Shëndetësisë, patën edhe një prononcim për gazetarë.

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 13:30

Përgatitur nga
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz